



Frank Hackett, Ed.D.  
Përgjegjës për shkollat

James Lee  
Ndihmës përgjegjës për shkollat

### Udhëzime dhe Kritere për Regjistrimin në Kopsht

Informacioni i mëposhtëm ofrohet si udhëzues për të gjithë prindërit që kanë në plan të regjistrojnë një fëmijë në Shkollat Publike Braintree.

#### Periudha 2020-2021

- Regjistrimi (21,23 & 25 janar)
  - Njoftim për sistemimin në kopshtin ditor gjatë javës që fillon më 34 shkurt
  - Depozita për kopshtin ditor duhet paguar në 28 shkurt
  - Përzgjedhja për kopsht
- **Fëmijët që hyjnë në kopsht duhet të kenë mbushur pesë vjeç para datës 31 gusht të vitit të regjistrimit.** Nxënësit dhe familjet duhet të jenë banorë të përhershëm të qytetit të Braintree dhe në gjendje japin një provë të rezidencës. Informacionin se çfarë është provë e pranueshme e rezidencës e kemi përfshirë në këtë paketë. Transporti ofrohet si opsion për të gjitha familjet. Transporti për nivelin fillor është falas.
  - Ligji i imunizimeve shkollore, Kreu 76, Seksioni 15 i Ligjeve të përgjithshme kërkon imunizim kundër difterisë, kollës së mirë, tetanosit, poliomielitit, fruthit, shytave, rubeolës, hepatitit B dhe lisë së dhenve, si dhe teste për helmim me plumb dhe tuberkuloz dhe një ekzaminim fizik aktual që përfshin ekzaminimin e të parit, përfshi të parit binokular. Kërkesat e imunizimit shkollor kërkojnë që çdo fëmijë që hyn në kopsht të paraqitë dëshmi se e ka marrë vaksinën e dytë të fruthit, shytave dhe rubeolës (MMR) dhe vaksinën e dytë të lisë së dhenve. Ligji thotë: “asnjë fëmijë, përveçse siç specifikohet në vijim, nuk do të pranohet në shkollë.” Konkretisht ju duhet të paraqitni:
    1. Një certifikatë nga mjeku që dëshmon për vaksinat që i janë bërë fëmijës dhe/ose sëmundjet që ka pasur fëmija; ose
    2. Një certifikatë nga mjeku që dëshmon se vaksinimi kundër-indikohet për arsye shëndetësore; ose
    3. Një deklaratë nga prindi ose kujdestari që imunizimi bie ndesh me besimin fetar përkatës.
    4. Një certifikatë që verifikon se fëmija juaj e ka kaluar me sukses testin e të parit, përfshi testin binokular, brenda 12 muajve të shkuar, të verifikuar në formularin e ekzaminimit fizik të përfshirë.
    5. Testimin për plumb, me rezultatet të regjistruara në formularin e ekzaminimit fizik.
    6. Vlerësim i rrezikut për tuberkuloz, i regjistruar në formularin e ekzaminimit fizik.
    7. Ekzaminim fizik i kryer brenda një viti që nga hyrja në shkollë